3. Bojrat të kenë afat skadence jo më pak se 1 vit, nga dita e lëvrimit të tyre dhe të shoqërohen me certifikatën e garancisë.

4. Operatori ekonomik duhet te paraqesë një deklaratë nëpërmjet të cilës të garantojë furnizimin me bojra origjinale të firmave prodhuese ose prodhuesve ekuivalente të paisjeve për printera, fotokopje dhe plotera. Bojërat duhet të jenë origjinale dhe jo kompatibël, jo të ricikluar, jo te rimbushura dhe të kenë pullën e garancisë së prodhuesit të pajisjeve. Te jene te ambalazhuara ne konfeksione te reja, të pahapura e te pademtuara me elementet perkates te sigurise/ vulë origjinaliteti. Emri i prodhuesit duhet të jetë i stampuar si në kutinë e bojës, në pullën e sigurisë si dhe kartrixhe. Numri serial i kutisë duhet të jetë i njëjtë me numrin serial të bojës.

5. Në rastin kur Operatori ekonomik nuk është furnitori i drejtëpërdrejtë, duhet të paraqesë marrëveshje bashkëpunimi (kontrate, akt-marreveshje ose cdo akt tjetër juridik qe verteton qarte lidhjen midis ofertuesit dhe furnitorit) te zyrtarizuar, te vlefshme ne ditën e hapjes se ofertave, per produktet e ofruara objekt prokurimi, e cila te vertetoje dhe te tregojë qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe furnitorit, ku te percaktohen edhe te dhenat e plota te furnitorit si: telefon, e-mail, website.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, të të gjithë artikujve të kërkuar në adresën e autoritetit kontraktor.

7. Për të garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për furnizimin që do të kryejnë, Operatori ekonomik duhet te paraqesë Certifikaten e Cilësisë ISO 9001- 2015 ose i përditësuar (e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). Certifikata kerkohet te jete e vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit.

Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomike cdo anetar i grupit duhet te paraqese certifikatat ISO sipas zerave te mallrave qe do te marre persiper te furnizoje sipas akt-marreveshjes.

** Në respektim të nenit 23 të LPP-së në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

SIPAS KERKESAVE TE PERCAKTUAR NE PREVENTIV

1. Të përputhen me cilësimet e dhëna në preventivin përkatës.
2. Të jenë origjinale dhe të cilësisë së parë.
3. Të jenë mallra shumë përdorimshe.

Specifikime teknike për tonerat (bojrat) :

- * Bojrat të kenë kapacitet maksimal të numrit të fletëve në printim / fotokopjim.
- * Bojrat të mos jenë të rimbushura apo kompatibël.
- * Bojrat duhet të kenë ambalazh origjinal. Të jenë të garantuara nga shiriti dhe pulla e sigurisë. Tek pulla e sigurisë duhet të jetë e shënuar marka e pajisjes.
- * Numri serial i kutisë duhet të jetë i njëjtë me numrin serial të bojës.
- * Bojrat të jenë origjinale të prodhuara nga prodhuesi i pajisjeve dhe me pullë sigurie.
- * Bojrat të jenë sipas përshkrimeve në preventivin përkatës.
- * Bojrat të kenë afat skadence jo më pak se një vit, nga momenti i lëvrimit të mallit.
- * Tonerat/Bojërat duhet të evidentohen nëpërmjet Part-Numberit përkatës, pasi është elementi kryesor dallues i përcaktuar në datashet-in dhe katalogun përkatës të llojit të printerit apo fotokopjes për të cilën nevojitet.
- * Tonerat për printera dhe fotokopje duhet të jenë Origjinale prodhuar nga prodhuesit e pajisjeve përkatëse (OEM,GENUINE), jo kompatibël , jo të rimbushur , jo remanufactured.
- * Tonerat/Bojërat duhet të përmbajnë pullën e sigurisë së prodhuesit "Genuine".(Ato tonera/bojëra të cilat prodhuesi i pajis me pullën e sigurisë "Genuine").

- * Tonerat duhet të jenë të reja, të papërdorura, të mbështjellë me qese dhe të ambalazuara në kuti, të shoqëruara këto me pulla sigurie nga prodhuesi. Tonerat duhet të plotësojnë të gjithë elementet e sigurisë dhe do të kryhet kontroll rigoroz për plotësimin e këtyre elementeve.
- * Modeli i printerit dhe kodi i bojës duhet të jenë të printuara në kuti dhe jo në etiketa që ngjiten. Numri i serisë së kutisë duhet të korrespondojë me numrin e serisë së cartridge brënda në kuti.
- * Tonerat për printera dhe fotokopje duhet të plotësojnë sasinë e faqeve sipas datashet-in dhe katalogut përkatës të pajisjeve(printera,fotokopje)
- * Tonerat linkjet duhet të ketë datë skandence jo më pak se 1 vit nga data e lidhjes së kontratës.
- * Operatori ekonomik duhet të ofrojë garanci për mallin e ofruar,si dhe ndërrimin nga difekte fabrikimi.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera (lekë)
A	Tonera për Njësinë Qëndër Bashkinë				
1	Bojë Printeri Xerox Phaser 3020	Copë	15		
2	Bojë Printeri Rico AFICIO MP 2051SPF (4x2) Set	Set	3		
3	Bojë Printeri Samsung Ml-1665	Copë	4		
4	Bojë Printeri Oki Mb 472	Copë	1		
5	Bojë Printeri OKI B 411dn	Copë	5		
6	Bojë Printeri Samsung Ml-1640	Copë	2		
7	Bojë Printeri Hp laserjet 1200 series	Copë	2		
8	Bojë printeri Ricoh AFICIO MP 201SPF	Copë	1		
9	Bojë Printeri Hp laserjet P 2015	Copë	2		
10	Bojë Printeri Xerox 5021	Copë	2		
11	Bojë Printeri Hp laserjet 1010	Copë	4		
12	Bojë Printeri Hp laserjet 1022	Copë	2		
13	Bojë Printeri KYOCERA 6525	Copë	10		
14	Cilindër printer Brother HL – 14-50	Copë	1		
15	Cilinder Hp laser Jet 2300n	Copë	1		
16	Bojë printer Hp laser Jet P 1005	Copë	2		
17	Bojë printer Kyocera FS 2200	Copë	4		
18	Bojë printer Laserjet Pro 400 M401 dn	Copë	4		
19	Bojë printer Ricoh MP 201 SFP	Copë	1		
20	Bojë printer HP laserjet P3015	Copë	2		
21	Drum Oki B411dn	Cope	5		
22	Bojë Printeri Ricoh AFICIO MP 201 SPF	Copë	1		
23	Printeri Xerox Versa Link C7025	Set x4	2		
	Për Njësinë Administrative Pishaj				
1	Bojë Printeri Oki B 411dn	Copë	1		
2	Bojë Printeri Kyocera -6525	Copë	1		
	Për Njësinë Administrative Kodovjat				
2	Bojë Printeri KYOCERA 6525	Copë	1		
	Për Njësinë Administrative Kukur				
1	Bojë Printeri KYOCERA 6525	Copë	1		
2	Bojë Printeri HP Q7551A (51A)	Copë	1		
	Për Njësinë Administrative Lenie				

Dokumentat Standarde të Tenderit

1	Bojë Printeri Xerox Phaser 3020	Copë	1		
2	Bojë Printeri KYOCERA 6525	Copë	1		
	Për Njësinë Administrative Skënderbegas				
1	Bojë Printeri Kanon “Lexmark E240”	Copë	1		
	Për Njësinë Administrative Tunjë				
1	Bojë Printeri KYOCERA 2200	Copë	1		
2	Bojë Printeri Kanon “Lexmark T652”	Copë	1		
	Për Njësinë Administrative Poroçan				
1	Bojë Printeri Samsung MI-1665,	Copë	1		
	Për Njësinë Administrative Sult				
1	Bojë Printeri KYOCERA 2200	Copë	1		
2	Bojë Printeri Oki B411 dn	Copë	1		
	Për Njësinë Administrative Kushovë				
1	Bojë Printeri Oki B 411dn	Copë	1		
2	Bojë Printeri Samsung SCX-4300	Copë	1		
3	Bojë Printeri KYOCERA 6525	Copë	1		
	Totali A				
B	Tonera për arsimin (shkollat e rrethit)				
1	KANON LBP 2900(origjinal)Drejtoria e Arsimit	Copë	3		
2	(OKI) B2200 (origjinal)Klubi Sportit	Copë	1		
3	Xerox Phaser 3020(origjinal),drej.e kop.D.Çekrezi	Copë	1		
4	Xerox Phaser 3020(origjinal) QKF	Copë	1		
5	Xerox Phaser 3020(origjinal),Gjergjovinë	Copë	2		
6	STUDIO 382 P (origjinal) Gjimnazi.	Copë	1		
7	Deskejet HP 6540(origjinal) Gjimnazi.	Copë	1		
8	HP Laser jet 1116-1320 49A(origjinal)Gjimnazi.	Copë	1		
9	Lexmark E-260 D (origjinal)gjimnazi.	Copë	1		
10	Dixhital, AR-5316G+ADF (origjinal) gjimnazi.	Copë	1		
11	Laserjet Pro 400 M 401 dn(origjinal) Gjimnazi	Copë	2		
12	Laserjet Pro 400 M 401 dn(origjinal), “Rilindje”	Copë	1		
13	XEROKS PHASER 3124 (origjinal) “Rilindje”	Copë	1		
14	Xerox Phaser 3124(origjinal), “35-Vjetori”	Copë	1		
15	Laserjet Pro 400M 401 dn, “35-Vjetori”	Copë	1		
16	Xerox Phaser 3124(origjinal), “A.Shahini)	Copë	1		
17	Laserjet Pro 400 M 401 dn (origjinal) “A.Shahini”	Copë	2		
18	Laserjet Pro 400 M 401 dn (origjinal),Sult	Copë	1		
19	Laserjet Pro 400 M 401 dn(origjinal) Skënderbegas	Copë	1		

Dokumentat Standarde të Tenderit

20	Laser Jet P2014 (origjinal) (Skënderbegas)	Copë	1		
21	Sharp AR 135 E (origjinal) fotokopje, Skënderbegas	Copë	1		
22	Laserjet Pro 400 M 401 dn (origjinal) Shëmriza	Copë	1		
23	Xerox Phaser 3010, Çekini	Copë	2		
24	Laserjet Pro 400 M 401 dn (origjinal) Driza.	Copë	2		
25	HP Laser Jet 3050 PCL 5 (origjinal) Poroçan	Copë	1		
26	Samsung ML 1450 2 (origjinal) Poroçan	Copë	1		
27	HP Laser Jet P2015dn (origjinal) Kodovjat	Copë	2		
28	HP Laser Jet P2015 dn (origjinal) Tunjë	Copë	2		
29	Laser Jet P 1005 (origjinal) Çerdhe	Copë	1		
30	Xerox (Phaser 3117 (origjinal) Kukur	Copë	1		
31	Laserjet Pro 400 M 401 dn (origjinal) Kukur	Copë	1		
32	SCX-4521F (origjinal) Lenie	Copë	2		
33	Samsung 2070 (origjinal) Kushovë	Copë	2		
34	HP P1102 CE285AD (origjinal) Lulet e Diellit	Copë	1		
35	Laserjet Pro 400 M 401 dn (origjinal) Gribë	Copë	2		
36	Laser Jet Pro 400 M 401 dn (origjinal) Mashan	Copë	2		
	TOTALI B				
C	Materiale Kancelarie Bashkia				
1	Dosje të thjeshta kartoni me përmasa 33cm*25cm	Copë	300		
2	Dosje me llastik, prespan trashësia e kartonit 450gr, 35cm*25cm	Copë	300		
3	Dosje me mekanizëm 8 cm dhe kutia përkatëse me përmasa 28cm*34cm*5 cm	Copë	25		
4	Dosje kuti me perçina 15 cm me përmasa 34.5*28*15	Copë	10		
5	Qese dokumentash (100 copë në 1 pako, 150 micron)	Pako	25		
6	Stilolapsa blu pensan tribal ose ekuivalent maja 1mm	Copë	500		
7	Stilolapsa të kuq pensan tribal ose ekuivalent maja 1mm	Copë	30		
8	Lapsa plumbi me gomë	Copë	20		
9	Gomë për laps dhe bojë	Copë	20		
10	Gomë dyngjyrëshe Kohinor ose ekuivalente e saj.	Copë	10		
11	Kolorë (me 4 ngjyra komplet, Power line)	Pako	20		
12	Korrektorë stilo 7ml	Copë	40		

Dokumentat Standarde të Tenderit

13	Bllloqe të vegjël shënimesh me ngjitje 100 fletë, me 76x76ml me ngjyra (stick notes)	Copë	50		
14	Blllok shënimesh me vija, me ngjitje, me lëkurë dhe kapak nga sipër me manjeto me 120 fletë. 25x18cm.	Copë	20		
15	Blllok shënimesh me kutia, me ngjitje me lëkurë dhe kapak nga sipër me manjeto me 120 fletë 25x18cm.	Copë	20		
16	Bojë vule ngjyrë blu	Copë	15		
17	Tampon vule ngjyrë blu	Copë	5		
18	Makinë kapëse letrash e madhe për kapje deri 300 flete (lebez)	Copë	2		
19	Kapëse letrash flutur e mesme (binder clips) 51 mm	Pako	7		
20	Makinë kapëse letrash e vogël që kap 30 deri 50 fletë (rotatable stapler) nr 24/6 (lebez)	Copë	20		
21	Kapëse letrash në formë U	Pako	15		
22	Kapëse letrash flutur madhe (binder clips) 67 mm	Pako	10		
23	Kapëse letrash flutur e vogël (binder clips) 25 mm	Pako	15		
24	Tela kapëse aktesh 24/6	Pako	60		
25	Tela kapëse aktesh staple 10	Pako	40		
26	Ngjitës letre tubet rrollestik 20 gr	Copë	20		
27	Ngjitës letre shirit transparent gjerësi 17mm	Copë	15		
28	Shina plastike për fiksion dokumentash A4 , 8mm	Copë	50		
29	Letra plastike A4 të tejdukshme me 100 copë pakoja	Pako	2		
30	Letra A4 me ngjyra të ndryshme, 80 gr (100 copë pakoja)	Pako	5		
31	Karton A4 me ngjyra të ndryshme 160 gr (100 copë pakoja)	Pako	5		
32	CD me kapak CD	Copë	50		
33	USB 16 GB	Copë	20		
34	Makinë llogaritëse e madhe me 30-35 butona me bateri AA1.5V	Copë Copë	5		
35	Metër shirit 20 ml	Copë	2		
36	Vizore metalike 30 cm	Copë	5		
37	Letër adeziv me ngjyra të ndryshme 1m x 0.7m	Copë	20		
38	Rapid ngjyre blu Pilot G-207 (0.5-0.7mm)	Copë	45		
39	Rapid ngjyrë të zezë Pilot G-207(0.5-0.7mm)	Copë	10		
40	Mbajtëse set kancelarie me aksesore përmasa 14.5 cm*11cm*10.5cm. Me 6 ndarje dhe mbajtëse për fletëpalosje	Copë	10		
41	Bateria aparati , AA1.5 V	Copë	10		

Dokumentat Standarde të Tenderit

42	Komplet me 24 ngjyra lapustila të trashë	Pako	7		
43	Dosje me 10 zarfa +zarf nga sipër me 150micron	Copë	40		
44	Dosje me 20 zarfa +zarf nga sipër me 150micron	Copë	30		
45	Dosje me 40 zarfa +zarf nga sipër me 150micron	Copë	30		
46	Mbajtëse dokumentash horizontale me 3 kate metalike	Copë	5		
47	Orë Muri me matës temperature dhe lagështire	Copë	3		
48	Makine heqëse teli të vogla, të thjeshta	Copë	10		
49	Dosje konference	Copë	5		
50	Axhendë format A4(17.2*24, 320 fq)	Copë	10		
51	Zarf plastik me dy anë te hapura, trashësi 300 micron(blu)	Cope	50		
52	Kosh metalik rrethor rrjete I zi, 22x26.5x28cm	Cope	7		
53	Zarfa A6	Cope	100		
	TOTALI C				
D	Materiale Kancelarie për Arsimin				
1	Dosje dokumentash 10zarfa+xhep nga sipër 150 mikron.	copë	10		
2	Dosje dokumentash 20zarfa+xhep nga sipër 150 micron.	copë	40		
3	Dosje dokumentash 40zarfa +xhep nga sipër 150 micron.	copë	4		
4	Dosje konference	copë	3		
5	Stik notes 76X76 mm	copë	80		
6	Bojë vule ngjyrë blu	copë	10		
7	Tampon vule ngjyrë blu	copë	10		
8	Karton i bardhë 220 gr./m2 me përmasa 1m x 0.7	copë	300		
9	Karton kolor (8 ngjyra,jo e zeza) me përmasa 1m x 0.7	copë	200		
10	Letër A-4 Color (me 8 ngjyra) 80gr.(100 fije pakua)	pako	5		
11	Zarfa të vegjël 11x23mm	copë	150		
12	Zarfa A-4	copë	40		
13	Zarfa A-3	copë	20		
14	Dosje të thjeshta kartoni me përmasa 34cm.*25cm.	copë	200		
15	Dosje me llastik karton i fortë 34cm.*25cm.	copë	70		

Dokumentat Standarde të Tenderit

16	Dosje me perçina me përmasa 34.5*24.5*4cm trashësi	copë	35		
17	Dosje kuti me perçina me përmasa 34.5*28*9 cm.	copë	30		
18	Dosje kuti kartoni e fortë për arkiv, me hapje sipër 40*30*16cm. model shtetëror.	copë	30		
19	Dosje me mekanizëm 8cm. me kuti përkatëse me përmasa 34.5*28*8cm.	copë	35		
20	Makinë kapse letrash të vogël që kap 25 fletë nr. 24/6 (lebez ose ekuivalente e saj)	copë	5		
21	Tela kapse aktesh 24/6	pako	80		
22	Tela kapse aktesh staple 10	pako	60		
23	Tela kapse aktesh staple 8	pako	10		
24	Nënvizues fibracolor me 4 ngjyra HI-TEXT FLASHER ose ekuivalente e saj	pako	50		
25	Kapse letrash në formë U	pako	80		
26	Blllok shënimesh me vija, me ngjitje, me lëkurë dhe kapak nga sipër me manjeto me 120 fletë. 25x18cm.	copë	35		
27	Blllok shënimesh me kutia, me ngjitje me lëkurë dhe kapak nga sipër me manjeto me 120 fletë 25x18cm.	copë	35		
28	Stilolapsa me ngjyrë blu maja 1mm pensan triball ose ekuivalente e saj.	copë	300		
29	Kapse letrash flutur të madhe(binder clip)41mm	pako	30		
30	Kapse letrash të vogla(binder clip) 25mm.	pako	35		
31	CD me kapak	copë	20		
32	Rapit me ngjyrë blu Shnajder ose Pilot 0.5-0.7mm ose ekuivalente e saj	copë	80		
33	Qeska dokumentash (100 copë në pako),150Mikron	pako	35		
34	Ngjitës letre shirit transparent gjerësi 17 mm	copë	150		
35	Ngjitës letre shirit transparent gjerësi 50mm.	copë	10		
36	Ngjitës letre tubet rrollestik 20gr.	copë	300		
37	Korrektorë stilo 7ml.	copë	70		
38	USB 4 GB	copë	10		
39	Flamur kombëtar me thurje	copë	80		
40	Gërshërë për prerje letra e karton	copë	20		

Dokumentat Standarde të Tenderit

41	Color Bic 4 ngjyra(e kuqe,blu,e gjelbër,e zezë,) ose ekuivalente e saj	copë	120		
42	Pako color me 12 ngjyra për fëmijët e kopshteve	copë	200		
43	Bojra uji color 12 copë pakua me penel për kopshte	pako	80		
44	Plastelinë Primo 250 gr. me 12 ngjyra për kopshte ose ekuivalente e saj	pako	80		
45	Shkumësa me ngjyra në pako me 100 copë GIOTTO ose ekuivalente e saj	pako	80		
46	Shkumsa të bardhë në pako me 100 copë GIOTTO ose ekuivalente e saj	pako	80		
47	Vinovil 60gr.	copë	50		
48	Tenie letër e hollë	copë	2		
49	Tenie letër e trashë	copë	2		
50	Vizore dur alumin 50 cm.	copë	3		
51	Fije e trashë lino	copë	3		
52	Pigment RS e kuqe	copë	8		
53	Pigment RS e verdhë	copë	4		
54	Pigment RS blu	copë	8		
55	Pigment RS e zezë	copë	4		
56	Pigment RS e gjelbër	copë	8		
57	Bojë plastike e bardhë	Kg.	20		
58	Set furçe për prerje	copë	2		
59	Set furçe për mbushje	copë	2		
60	Rrula të vegjël plus skaf	copë	1		
61	Rrula të mëdhenj plus skaf	copë	4		
62	Set penelash për bojë vaji	copë	2		
63	Set penelsh për akrilike	copë	2		
64	Set penelash për akuarele	copë	2		
65	Penela për pastrim pluhuri(Soft) Set	copë	3		
	Totali D				
	TOTALI A + B + C+ D (pa TVSH)				
	TVSH			20%	
	SHUMA TOTALE (me TVSH)				

Afatet e lëvrimit:

30 ditë nga lidhja e kontratës.

Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR²

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

² Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

< Emri >

Shtojca 13

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsye të mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.

- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të

kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronësia intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrijë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilesinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës së shitesit (Kontraktuesit).

Neni 10: Pjesët e Këmbimit

- 10.1 Nëse është e parashikuar në kontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvruara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë përkatëse të kontratës.
- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.
- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetëgjatësinë e përdorimit të Mallrave.
- 10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një kohe të arsyeshme/mjaftueshme për t'i lënë mundësi atij që të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.
- 10.5 Pas ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet t'i japë pa pagesë Autoritetit Kontraktor, nëse ai e kërkon, çdo prodhim, vegël, skicim të pjesëve të këmbimit të përdorura në prodhimin dhe mirëmbajtjen e Mallrave.

Neni 11: Ambalazhimi

- 11.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat të vendosura dhe të ambalazuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 11.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë nen tjetër i kontratës, mund të thuhet se Mallrat nuk janë vendosur dhe paketuar në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë vendosur dhe paketuar në të njëjtën mënyrë që bëhet zakonisht për gjërat e të njëjtit lloj ose, nëse mënyra e zakonshme nuk është e disponueshme, në një mënyrë që është e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e Mallrave.

Neni 12: Testimet dhe Inspektimet

- 12.1 Kontraktuesi duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktuesi brenda kushteve të çmimit të kontratës
- 12.2 Me shpenzimet e tij, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet.
- 12.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë Kontraktuesit të bëjë teste ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Mallrat janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Më tej, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së Kontraktuesit, Autoriteti Kontraktor do të pranojë të ndryshojë grafikun e lëvrimit.
- 12.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Mall që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.
- 12.5 Ekzekutimi i testeve, apo inspektimi i Mallrave nuk e shkarkojnë Kontraktuesin nga garancitë apo detyrimet e tjera sipas kontratës.

Neni 13: Kushtet e Dorëzimit

- 13.1 Kontraktuesi është i detyruar të kryejë të gjitha aktivitetet dhe veprimet e dorëzimit përveçse kur Kontraktuesi përjashtohet në mënyrë specifike nga një aktivitet ose veprim i tillë nga ndonjë dispozitë e kontratës. Nëse një Incoterm përdoret për të përshkruar detyrimet e palëve, termi do të ketë kuptimin që i ka dhënë botimi i fundit i *Incotermave* botuar nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.
- 13.2 Vendi i dorëzimit të Mallrave do të jetë sipas specifikimit të kontratës.
- 13.3 Koha e dorëzimit të Mallrave dhe data e përfundimit të Shërbimeve të lidhura me to do të jetë sipas specifikimit në kontratë.
- 13.4 Dorëzimi i Mallrave duhet të bëhet gjatë orarit të punës me përjashtim të rastit kur kjo kërkesë bie ndesh me ndonjë dispozitë të kontratës.

13.5 Kontraktuesi është i detyruar të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një periudhe kohore të arsyeshme për dorëzimin e Mallrave përpara arritjes së tyre.

Neni 14 Transportimi i Mallrave

